



FTESË PËR PJESËMARRJE **NË PANAIRIN NDËRKOMBËTAR “FRUIT LOGISTICA” BERLIN 2024**

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në cilësinë organizatorit për pjesëmarrje, Ju fton të bëheni pjesë e Panairit Ndërkombëtar **"Fruit Logistica"** në datat **7 – 8 – 9 shkurt 2024**, që zhvillohet në **Berlin, Gjermani**.

Fruit Logistica është një nga panairët më të mëdha në botë për biznesin ndërkombëtar të frutave dhe perimeve të freskëta, që mbulon çdo sektor të biznesit të produkteve të freskëta dhe siguron një tablo të plotë të inovacioneve, produkteve dhe shërbimeve më të fundit në çdo hallkë në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit.

Ofron mundësi të shkëlqyera të rrjetëzimit dhe kontaktit për vendimmarrësit kryesorë në çdo sektor të industrisë përmes shkëmbimit të informacioneve, krijimin e kontakteve dhe kontratave të bashkëpunimit.

Mbi 2.600 ekspozues si dhe mbi 60.000 vizitorë e tregtarë, marrin pjesë në Fruit Logistica çdo vit për të promovuar potencialin e tyre të biznesit, brenda tregtisë ndërkombëtare të produkteve të freskëta dhe për të shkruar historinë e tyre të suksesit.

Grupet e synuara për të marrë pjesë në këtë panair janë sipërmarrjet që operojnë në sektorin e fruta – perimeve, pikat e grumbullimit, përpunues dhe agropërpunues.

Ftojme të gjitha kompanitë që i përkasin kategorive të sipërpërmendura, të cilat kanë certifikimin **GlobalG.A.P** si dhe mundësi dhe sasi eksportuese të marrin pjesë duke na dërguar me e-mail një prezantim të shkurtër të kompanisë, certifikimin GlobalG.A.P si dhe mundësinë eksportuese.

Pjesëmarrja Juaj në këtë panair mbështetet nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

*Për të siguruar pjesëmarrjen, lutemi të konfirmoni brenda datës **28 dhjetor 2023** në info@bujqesia.gov.al*

Në vijim, do t'Ju informojmë mbi detaje të mëtejshme rreth pjesëmarrjes Suaj në këtë aktivitet.